



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Raport për tremujorin e tretë 2021

Oda e Mjekëve të Kosovës



Tetor 2021

Prishtinë

Përmbajtja:

Raport për tremujorin e tretë 2021	1
1. Këshilli Drejtues.....	3
2. Anëtarësimi	3
3. Mbikëqyrja etiko-profesionale.....	4
4. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional.....	5
5. Licencimet.....	6
6. Edukimi specialistik - zbërthimi i kompetencës bazuar në Ligjin për Shëndetësi dhe Ligjin për OPSH-të	6
7. Këshilli Mbikëqyrës	7
8. Komisioni për çështje Etike i OMK-së	7
9. Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke.....	7
10. Raporti financiar.....	8
10.1 Raporti financiar për periudhën deri me 30 shtator 2021	8
10.2 Përkrahje për Edukim të Vazhdueshëm Profesional	9
10.3 Prokurimi	9
11. Aktivitete të tjera.....	9
11.1 Zgjedhjet për legjislaturën e III-të të OMK-së	9
11.2 Botimi i Revistës Mjeku	10
11.3 Kongreset vjetore.....	10
11.4 Tryeza e rumbullakët - “Kualiteti i shkollimit universitar dhe pasuniversitar i mjekëve”.....	11
11.5 Marrëdhëniet ndërkombëtare.....	12
11.6 Bashkëpunimi profesional dhe veprimtaria ekspertike	12
12. Plani i veprimit për vitin 2021	13

1. Këshilli Drejtues

Në periudhën kohore korrik - shtator 2021, Këshilli Drejtues i OMK-së ka mbajtur tre (3) takime, ku janë shqyrtuar lëndët si më poshtë:

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën TM 3	Vendimet sipas kërkesave/a nkesave të pranuar për periudhën TM 3	Vendimet në procedurë	Vendimet e Këshillit Drejtues për periudhën TM 3	Vendimet për lëndët e bartura nga periudhat paraprake
Këshilli Drejtues i Odës	6	6	0	1-Vendim për fillimin e procedurave të prokurimit për furnizim me faksimila; 2- Vendim për publikimin e njoftimit për rekrutimin e 2 zyrtar-e administrativ-e si zëvendësues i pushimit të lehonisë; 3- Vendim - Aprovohet Raporti për TM2 2021; 4- Vendim për marrjen e ISBN numer për abstraktet e Kongresit të II të Mjekësisë në fushën e Onkologjisë; 5- Vendim për marrjen e ISBN numer për abstraktet e Kongresit të III të Mjekësisë Pandemia Covid19 Sfidat dhe Përvojat;	1

2. Anëtarësimi

Gjatë periudhës kohore korrik - shtator 2021, në Odën e Mjekëve të Kosovës u anëtarësuan 117 mjekë, nga të cilët janë 5 mjekë të punësuar në sektorin publik, 12 mjekë të punësuar në sektorin privat dhe 100 mjekë të papunë.




Tabela 1.1: Anëtarësime për periudhën kohore korrik - shtator 2021




Tabela 1.2: Totali i përgjithshëm i anëtarëve deri më datën 30 shtator 2021

Gjatë kësaj periudhe janë ndarë nga jeta 8 mjekë si dhe është rianëtarësuar 11 mjek, si rezultat numri total i anëtarëve deri me datën 30 shtator është 4606 mjekë.

3. Mbikëqyrja etiko-profesionale


Për ta pasqyruar ecurinë e mbikëqyrjes etike dhe profesionale pranë organeve të Odës, në mënyrë tabelare do të paraqesim ushtrimin e funksionit të tillë nga ana e organeve të odës.

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën TM3	Vendimet sipas procedurës së zhvilluar për periudhën TM3	Sanksionet e shqiptuara për periudhën TM 3	Sanksionet e ekzekutuara për periudhën TM 3	Lëndët e bartura nga periudhat paraprake	Lëndët në shqyrtim
Prokurori i Odës	25	5	///	///	10	26
Këshilli Etik	7	8	Rekomandime kolegjale 1 Qortim Publik 3 Gjoha : 3 gjobë nga 1000 € Gjithesëj : 0 00.00€	Qortim publik 0 (00.00€) Gjoha 0 (0.00€) Gjithesëj: 00.00€ Shpenzime te paushallit : 350€	6	0
Gjyqi i Nderit	0	0	0	///	0	0
Certifikatat e të kaluarës etike	60	///	///	///	///	///

Në shqyrtime të drejtpërdrejtë, Gjyqi i Nderit nuk ka mbajtur takime për periudhën raportuese korrik-shtator, meqenëse GJN nuk ka pranuar asnjë lëndë.


4. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional

Komisioni për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional gjatë periudhës TM 3 2021 ka akredituar 16 aktivitete. Në kuadër të aktiviteteve të akredituara, dy shoqata kanë bërë kërkesë për përkrahje financiare për organizimin e aktiviteteve, kërkesa këto që edhe janë aprovuar nga Komisioni.



5. Licencimet

Komisioni për Licencim dhe Rilicencim profesional gjatë periudhës korrik -shtator 2021, ka lëshuar 204 licenca me kategoritë si në grafikun e mëposhtëm:



6. Edukimi specialistik - zbërthimi i kompetencës bazuar në Ligjin për Shëndetësi dhe Ligjin për OPSH-të

Dizajnimi dhe fillimi i fazës kalimtare të zbërthimit të kompetencave të edukimit specialistik (zbërthimi ligjor, financiar dhe teknik) është në proces e sipër, duke përfshirë edhe hartimin e UA-së për shkollim specialistik.

Por në ndërkohë, bazuar në Nenin 9, paragrafi 1, me nënparagrafin 1.7, të Ligjit për OPSH-të, si dhe Nenin 72, paragrafi 5, të Ligjit për Shëndetësi, OMK ka

kërkuar auditim të procesit pasiqë ka konstatuar dhe faktuar një mori shkeljeve ligjore. Procesi i auditimit ka filluar nga ana e MSh-së.

7. Këshilli Mbikëqyrës

Në periudhën kohore korrik- shtator 2021, Këshilli Mbikëqyrës i OMK-së ka mbajtur dy (2) takime, ku i kanë shqyrtuar Rregulloret dhe vendimet e Këshillit Drejtues të OMK-së.

8. Komisioni për çështje Etike i OMK-së

Në periudhën kohore korrik- shtator 2021, Komisioni për Çështje Etike i OMK-së ka pranuar trembëdhjetë (13) kërkesa për leje për hulumtim dhe ka shqyrtuar dymbëdhjetë (12) nga këto kërkesa.

9. Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke

Në periudhën kohore korrik- shtator 2021, Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke ka pranuar dy (2) kërkesa për përkrahje financiare. Komisioni ka marrë vendim aprovues lidhur me këto kërkesa.

10. Raporti financiar**10.1 Raporti financiar për periudhën deri me 30 shtator 2021**

1.0 Të hyrat:				
1.1 Të hyrat e shtyera nga 2020	€ 475,907			
Total të hyrat e shtyera nga 2020	€ 475,907			
1.1 Të hyrat	Realizimi: TM1	Realizimi: TM2	Realizimi: TM3	TOTAL
1.1.1 Të hyrat nga anëtarësia:				
1.1.2 Anëtarësimi i mjekëve shtetas kosovarë	€ 264,512	€ 63,041	€ 17,355	€ 344,908
1.1.3 Anëtarësimi i mjekëve shtetas jo kosovarë	€ 2,000	€ 5,500	€ 4,955	€ 12,455
1.1.4 Licencimi	€ 9,700	€ 7,950	€ 10,820	€ 28,470
1.1.5 Të hyrat e tjera*	€ 8,366	€ 6,645	€ 19,229	€ 34,240
1.1.6 Xhirollogaria për ndërtimin e obeliskut në nder të profesionistëve shëndetësor-Projekt i përbashkët i OPSH-ve			€ 1,740	€ 1,740
Të hyrat deri me 30.06.2021	€ 284,578	€ 83,136	€ 54,099	€ 421,813
Të hyrat e shtyera nga 2020				€ 475,907
TOTAL TË HYRAT				€ 897,720

2.0 SHPENZIMET	Shpenzimet: TM1	Shpenzimet: TM2	Shpenzimet: TM3	TOTAL
2.1 Paga, meditje dhe kontributet pensionale	€ 40,596	€ 49,786	€ 39,924.13	€ 130,307
2.2 Material shpenzues	€ 4,923	€ 239	€ 781.64	€ 5,943
2.3 Reprerentacioni	€ 642	€ 587	€ 587.16	€ 1,816
2.4 Edukimi i vazhdueshëm profesional	€ 2,000	€ 3,250	€ 23,002.41	€ 28,252
2.5 Shpenzimet e tjera*	€ 8,793	€ 7,917	€ 5,416	€ 22,126
2.6 Shpenzimet e asetëve		€ 148	€ 1,166.92	€ 1,315
2.7 Përkrahje financiare në kuadër të fondit për solidaritet	€ 8,000	€ 4,250	€ 4,050	€ 16,300
2.8 Xhirollogaria për ndërtimin e obeliskut në nder të profesionistëve shëndetësor-Projekt i përbashkët i OPSH-ve			€ 32	€ 32
TOTAL SHPENZIMET 30.06.2021	€ 64,954	€ 66,177	€ 74,960	€ 206,091

TOTAL BILANCI				€ 691,629
----------------------	--	--	--	------------------

1.1.5* Taksë administrative për aplikim për ndërrim të kartelës, Regjistrimi në regjistrin e anëtarësisë së OMK-së, faksimili, faksimili i dytë, kongreset, simpoziumet, seminarët, konferencat vendore pa pjesëmarrje ndërkombëtare, aktivitetet e organizuara nga kompanitë farmaceutike, certifikatat për të kaluarën etike, lejimi për hulumtime biomjekësore për anëtarë të Odës, të hyrat nga dënimet (masat disiplinore), dhurata/donacione, të ardhurat të tjera.

2.5 *Faksimili, anëtarësimi në CPME, shpenzimet e tel., shpenzimet e int., shpenzimet e postës, pajisje të TI-së, shpenzime bankare, shpenzimet e pastrimit, shpenzimet e transportit, inventari, shpenzimet e tjera operative. Organizimi i mbledhjes së Kuvendit.

2.7* Tek përkrahja për solidaritet përveç mjeteve të ndara për mjekët të cilët kanë lënguar nga ndonjë sëmundje, janë të përfshira edhe mjetet e ndara për familjet e mjekëve të cilët kanë ndërruar jetë si pasojë e infektimit me virusin COVID-19, bazuar në Vendimin e Këshillit Drejtues me nr. Ref. 53/20.

10.2 Përkrahje për Edukim të Vazhdueshëm Profesional

Oda e Mjekëve të Kosovës gjatë periudhës korrik- shtator 2021 ka akorduar përkrahje financiare për,

- Kolegjin e Kirurgëve të Kosovës në bashkorganizimin e “Kongresin e Parë Klinik”, me vlerë 22,592.00 €
- Shoqata Kosovare për Menaxhimin e Rrugëve të Frymëmarrjes në bashkorganizimin e “5th Advanced Airway Management workshop – Difficult Airway for Anesthesiologist and Surgeons”, me vlerë 2,000.00 €

10.3 Prokurimi

Gjatë periudhës kohore korrik-shtator 2021 u zhvillua një procedurë e hapur e prokurimit:

Në muajin korrik u bë ftesa për u bë ftesa për tender nga Oda e Mjekëve të Kosovës për të gjitha kompanitë e interesuara që të paraqesin ofertën e tyre për dosje të tenderit/konkursit për “Projektin ideor për Monumentin përkujtimor për nder të profesionistëve shëndetësorë”. Si rezultat i kësaj ftese është pranuar ofertë nga një operator ekonomik, ku përzgjedhja e operatorit ekonomik u bë sipas konformitet cilësor të shërbimit të ofruar, duke u mbështetur në arsyeshmërin e çmimit të ofruar dhe pasi që operatori ekonomik ka plotësuar të gjitha kërkesat në përputhshmëri me kërkesat e dosjes së tenderit.

11. Aktivitete të tjera

11.1 Zgjedhjet për legjislaturën e III-të të OMK-së

Oda e Mjekëve të Kosovës si një organizatë e pavarur profesionale e mjekëve, këtë vit mban zgjedhjet e saj për legjislaturën e saj të tretë.

Kuvendi OMK-së, në mbledhjen e dates 15 qershor 2021, ka përzgjedhur Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në përbërje prej:

1. Dr. Adem Nura, kryesues i KQZ-së,
2. Dr. Shaban Osmanaj zv. Kryesues,
3. Dr. Agron Kamberi, anëtar,
4. Dr. Rexhep Manaj, anëtar,
5. znj.Arbnora Duriqi, anëtare

Sipas kodit zgjedhor miratuar nga kuvendi i OMK-së, Zgjedhjet e rregullta për Kuvendin e OMK-së shpallen nga KQZ-ja 30 ditë para mbajtjes së tyre dhe afati për mbajtjen e zgjedhjeve është jo më vonë se 30 ditë pas përfundimit të mandatit. Në këtë drejtim, zgjedhjet do mbahen në muajin dhjetor.

Sipas procedurave të kodit zgjedhor, fillimisht bëhet përgatitja e një liste votuese e cila quhet Listë zgjedhore, ku do të përfshihen të gjithë anëtarët të cilët janë të regjistruar në Odën e Mjekëve të Kosovës, e që gëzojnë të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur. Pjesë të kësaj liste do të jenë edhe mjekët e rinjë të cilët diplomojnë deri para mbajtjes së zgjedhjeve.

Mandati i një legjislature është për 4 vite dhe këto janë zgjedhet e treta me radhë që do të mbahen në OMK.

11.2 Botimi i Revistës Mjeku

Gjatë periudhës korrik- shtator, u publikuan dy numra të Revistës Mjeku.

Në mujin Korrik u bë publikimi i revistes me temë bosht “Onkologjia”. Artikujt interesantë të këtij numri prezentojnë aspekte të ndryshme të kësaj problematike të veçantë mjekësore.

Në muajin Tetor u bë publikimi i revistes me temë bosht “Kujdesi Parësor”. Artikujt interesant të këtij numri prezentojnë aspekte të ndryshme kujdesit parësor në shtetin tonë, aktualitetet në OMK dhe disa artikuj tjerë relevant dhe cilësor.

Revista është e publikuar edhe online në faqën e Odës së Mjekëve të Kosovës (linku: [REVISTA MJEKU](#)) në mënyrë që të arrijë audiencë sa më të gjerë.

11.3 Kongreset vjetore

Ndër aktivitetet kryesore që Oda e Mjekëve ka planifikuar të realizoj për vitin 2021 janë Kongreset vjetore Mjekësore.

Kongresi i Dytë i Mjekësisë - Onkologji

Me datë 20 Korrik është bërë hapja e mundësisë për regjistrim të pjesëmarrësve.

Në formën e regjistrimit është limituar numri i pjesëmarrësve fizik në 200 mjekë, pas mbushjes të këtij numri, të gjithë pjesëmarrësit kanë mundësinë të regjistrohen vetëm për përcjellje virtuale të kongresit.

Pasi që gjendja me pandeminë gjatë muajit shtator është përmirësuar, këshilli organizativ i ka bërë kërkesë Qendrës operative emergjente të Kosovës për lejin e mbajtjes së kongresit për numër të caktuar të pjesëmarrësve (deri në 300 persona) në mënyrë fizike.

Pjesëmarrja në kongres për të gjithë anëtarët e Odës së Mjekëve të Kosovës ka është pa pagesë.

Këshilli Shkencor ka vlerësuar dhe përzgjedhur 58 abstrakte të punimeve për prezantim. Kongresi do të mbahet me datë 15 dhe 16 tetor 2021, ndarë në 8 sesione

- Pulmologji
- Trakti gastrointestinal
- Trakti urogjenital
- Kokë dhe qafë
- Gjinekologji
- Gjiri
- Onkologji pediatrike
- Hematoonkologia

Brenda afatit për aplikim për sponsorizim të kongresit, kanë dorëzuar ofertat disa kompani ku kompania Hoffman-La Roche është shpallur sponsor i artë, kurse kompania ACIBADEM sponsor i argjendtë, përzgjedhja është bërë sipas ofertave më të larta. Gjithashtu AQH ka shprehur gatishmërinë përmes donacioneve ta përkrah këtë aktivitet.

Kongresi i Parë Klinik

Kolegji i Kirurgëve të Kosovës së bashku me Odën e Mjekëve të Kosovës, me datë 23-26 Shtator, organizuan Kongresin e Parë Klinik.

Në këtë kongres u prezantuan tema të ndryshme prej të gjitha disiplinave kirurgjike nga mbi 40 ligjërues të huaj dhe 50 vendorë. Kongresi u organizua në mënyrë fizike për numër të caktuar të pjesëmarrësve dhe për pjesën tjetër në mënyrë virtuale. Përgjat ditëve të kongresit ishin mbi 600 kirurgë nga të gjitha specialitetet kirurgjike me prezencë fizike ose online.

11.4 Tryeza e rrumbullakët - “Kualiteti i shkollimit universitar dhe pasuniversitar i mjekëve”

Me datë 22 korrik 2021 u mbajt Tryeza e rrumbullakët me temën “Kualiteti i shkollimit universitar dhe pasuniversitar i mjekëve”. Në tryezë morrën pjesë përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë, Bordi i Drejtorëve të ShSKUK-së, Rektorati i Unisversitetit të Prishtinës, Përfaqësues nga dekanati i Fakultetit të Mjekësisë, Bordi Qëndror për Shkollim Specialistik, Kryetarët e OPSH-ve, Përfaqësues të projektit Lux-Dev, Përfaqësues të specializantëve etj.

Qëllimi i kësaj tryeze është diskutimi mbi atë se çfarë na ka brengosur deri tani, e ndër to është në mos reflektimin i shumë problemeve që kanë atakuar mjekësinë tonë dhe qasjen e specializantëve në Kosovë.

Nga hulumtimet e bëra nga OMK, del si rezultat se 34.4% prej specialistëve kanë vlerësuar që planprogrami nuk është përmbushur aspak.

11.5 Marrëdhëniet ndërkombëtare

Oda e Mjekëve të Kosovës morri pjesë në konferencën virtuale të organizuar nga Forumi Evropian i Shoqatave Mjekësore (EFMA). Temë e konferencës ishte "Luftimi i pandemisë - A duhet të jetë një opsion vaksinimi i detyrueshëm?"

Konferenca u përqendrua në çështjen e vaksinimit COVID-19 dhe u mbajt në një format debati ku u shpalosën argumente për mbështetje dhe kundër vaksinimeve vullnetare dhe të detyrueshme.

Hapjen e kësaj konference e bëri Z. Leah Wapner, sekretar i përgjithshëm i Forumit Evropian të Shoqatave Mjekësore, më pas Dr. Jacques de Haller, president i Komitetit të përhershëm të mjekëve Evropian dha një pasqyrë të përgjithshme të situatës aktuale në Evropë.

Ndërsa hapjen e debatit e bëri Prof. Zion Hagay, President në Shoqatën Mjekësore Izraelite, me temën Luftimi i pandemisë, A duhet të jetë një opsion vaksinimi i detyrueshëm?

Në këtë konferencë morrën pjesë edhe zyrtarë të tjerë të rëndësishëm të fushës së mjekësisë në nivelin Evropian.

Kryetari i OMK-së, në këtë konferencë raportoi për situatën aktuale në Kosovë sa i përket pandemisë COVID-19, si dhe shpjegoi situatën dhe procesin e vaksinimit.

11.6 Bashkëpunimi profesional dhe veprimtaria ekspertike

Në kuadër të kompetencës publike lidhur me mbikëqyrjen e veprimtarisë profesionale të mjekëve, Kryetari i OMK-së duke u bazuar në kompetencat ligjore sipas Ligjit për OPSH-të, në bazë të kërkesave nga Këshilli Etik i OMK-së dhe Prokurori i OMK-së, ka caktuar ekspertë apo grupe të ekspertëve lidhur me konstatimin e përgjegjësisë profesionale mbi zbatimin e procedurave mjekësore nga mjekët gjegjës.

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën korrik-shtator	Vendimet sipas urdhëresave të pranuar për periudhën korrik-shtator	Në procedurë	Raportet e ekspertizave të përfunduara për periudhën korrik-shtator	Vendime për lëndët e bartura nga periudhat paraprake
Kryetari i Odës	0	0	0	2	1

12. Plani i veprimt për vitin 2021

Projektet afatmesme dhe afatgjata

- Projekti për ndërtimin e një objekti për të gjitha OPSH-të mbështetur nga MSH-ja, financuar nga Projekti KSV/017 “Përkrahja për Sektorin e Shëndetësisë”. Kësaj iniciative i janë përgjigjur të gjitha OPSH-të dhe kërkesa zyrtare për mbështetje është nënshkruar nga të gjitha ato dhe më pas është dorëzuar në MSH. Fillimi i ndërtimit pritet pas dhënjes së përlqimit nga ana e ShSKUK-së dhe MSh-së për parcelën për ndërtim. Pëlqimi pritet javëve në vijim
- Pas miratimit të kërkesës nga OMK drejtuar LuxDev-it lidhur me përkrahjen financiare për zhvillimin e sistemit informativ/bazës interaktive të të dhënave, ku do të përfshihen të gjitha proceset e OMK-së. Kohëzgjatja e projektit është 1 vit.
- Zbërthimi dhe bartja e kompetencave për edukimin specialistik bazuar në Ligjin për Shëndetësi dhe Ligjin për OPSH-të.
- Botimi i numrit të 4 të “Revistës Mjeku” me temë “Vaksinat”
- Organizimi i Kongresit të III multidisiplinar me fokus COVID-19
- Organizimi i Konferencës ndërkombëtare të Bioetikës
- Organizimi i zgjedhjeve për legjislaturën e III-të të OMK-së